

Mundësi punësimi:
Financier/e/ pranë Qendrës për Nisma
Ligjore Qytetare

Tiranë, më 06.09.2023

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare njofton të gjithë personat e interesuar se shpall pozicionin vakant për Financier/e me kohë të plotë me,

- Kontratë pune 1 vjeçare, me të drejtë ri-përtëritje, në varësi të performancës dhe mundësive të organizatës;
- Me kohë të plotë;

Përshkrimi i Pozicionit të Punës:

- Financieri/ja do të jetë përgjegjës/e për kryerjen e transaksioneve financiare të tre projekteve të organizatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregullat e prokurimit dhe rregulloret përkatëse të donatorëve, kodit të punës, dhe kërkesave të auditit.
- Regjistrimin dhe mbajtjen e të gjithë dokumentacionit të arkës dhe të bankës, dhe gjithë dokumentacionin mbështetës tjetër financiar që është në ruajtje në arkivën e qendrës.
- Financieri/ja do të jetë përgjegjës/e për përgatitjen e raporteve financiare, të transaksioneve dhe raportimin e tyre për secilin nga tre projektet. Detyra të veçanta specifike janë të përcaktuara në manualin e procedurave dhe politikave të qendrës.
- Financieri/ja do të mbështesë Menaxheren e Financës për raportimet financiare, auditet dhe bilancin.
- Financieri/ja kërkohet të ketë njohje të mirë të legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse të veprimtarisë ekonomike të organizatave jofitimprurëse si dhe të subjekteve fitimprurëse.
- Eksperiencia në sektorin e shoqërisë civile ose në sektorin privat është një aset. Pozicioni i punës kërkon një angazhim me kohë të plotë.
- Raporton çdo muaj mbi situatën financiare të tre projekteve në ngarkim, dhe realizimin e buxheteve të tre projekteve tek Drejtori Ekzekutiv;
- Detyra të tjera që lidhen edhe me mbështetjen në koordinimin e projekteve të qendrës;

Kualifikimet e kërkuara:

- Te këtë mbaruar studimet për Ekonomi, preferohet Dega Financë.
- Të ketë eksperiencë pune në menaxhimin financiar të projekteve në shoqërinë civile, dhe/ose në sektorin privat.
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze.
- Të jetë i/e motivuar dhe fleksibël me ngarkesën e punës.
- Të jetë sistematik i programuar dhe të ketë njohuri në ruajtjen e dokumentacionit financiar.
- E preferueshme të ketë njohuri e të punojë me programin Alpha dhe të njoh shumë mirë paketën microsoft office, veçanërisht Excelin .
- Te jetë i/e gatshëm të punojë dhe me orare të zgjatura kur të ketë nevojë qendra.
- Eksperiencia në koordinimin e projekteve përbëjnë një aset;

Aftësitë Individuale

- Aftësi të shkëlqyera komunikimi;
- Aftësitë e punës në grup;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe me integritet;
- Të jetë përgjegjës për respektimin e detyrave dhe afateve të përcaktuara;

Preferohen:

Kandidatët me përvoja të mëparshme në organizatat e shoqërisë civile.

Në përputhje me Nenin 142 të Kodit të Punës, të ndryshuar, “Koha e provës” konsiderohet si kohë prove 3 muajt e parë të punës.

Me qëllim aplikimin në këtë pozicion kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

1. CV e kandidatit/es;
2. Kopje të Diplomës, të shoqëruar me kopje të listës së notave të studimeve Bachelor dhe /ose Master, ose ekuivalente me to;
3. Dokument që provon njohuritë e gjuhës angleze;
4. Çdo dokumentacion të nevojshëm që tregon kualifikimet e kandidatit/es dhe përvojat e mëparshme;
5. Vërtetim nga punëdhënësi i mëparshëm me kontaktet e punëdhënësit;
6. Dëshmi penaliteti

Paga bruto është 99,500 lek në muaj.

Afati i fundit i aplikimeve do të jetë data 27 Shtator 2023, ora 16.00.

Dokumentacioni mund të dërgohet i skanuar në adresën e emailit avokatore2@yahoo.com ose, të depozitohet pranë zyrave të Qendrës për Nisma Ligjore me adresë Rruga “Vaso Pasha” Pll.12, Shk.1, Ap. 1 Tiranë.

Kandidatët e shortlistuar do të njoftohen dhe mund të thirren në një intervistë.

Shënim: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare rezervon të drejtën të anulojë thirrjen, nëse kandidatët nuk përmbushin kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara për këtë pozicion pune.